



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

---

Numri i lëndës: 2021:132886

Datë: 17.05.2022

Numri i dokumentit: 03022120

PPP.nr.1022/21

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Gent Bekeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, “A.G.” me adresë Rr. “ A.B.” p.n R., me ..., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit R. D.B., kundër debitorit Komuna e M., të cilën e përfaqëson M. S. Avokat Publik, lidhur me çështjen përmbartimore pagimin e borxhit në vlerë prej 8.547,75 Euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr. 266/21 të datës 08.06.2021, të lejuar nga zyra e përmbartuesit privat S. K. e emëruar në territorin e Gjykatës Themelore P., jashtë seancë më datën 17.05.2021, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I.** APROVOHET pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e M., dhe SHFUQIZOHET Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr. 266/21 i datës 08.06.2021, për shumën prej 8.547,75 Euro për shkak të përmbushjes së detyrimit.
- II.** REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e M. dhe mbetet në fuqi Urdhri përmbartimor P.nr. 266/21 i datës 08.06.2021 i përmbartuesit privat S. K., vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat i emëruar në territorin e Gjykatës Themelore në P., duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm faturës me numër 42 të datës 23.02.2021, ku debitori ishte i obliguar që ti paguaj kreditorit borxhin prej 8.547.75 Euro, me kamat ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbimore, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër urdhrin të përmbaresit privat, P.nr. 266/21 të datës 08.06.2021 për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësim debitori e kundërshton urdhrin përmbarimor duke kontestuar shumën e borxhit, pasi që fatura nuk i plotëson kushtet për përmbarim sipas nenit 29 të LPP-së, si dhe mos përmbushjen e kontratës dhe kushteve kontraktuale, duke i propozuar Gjykatës që urdhrin përmbarimor P.nr. 266/2021 ta anuloj si të pa bazuar.

Në afatin e paraparë ligjor kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilën e kundërshton prapësimin e debitorit si të pa bazuar pasi që i njëjti nuk është mbështetur në dispozitat e LPP-së nuk ka ofruar as një provë lidhur me pretendimet e paraqitura konform nenit 69 par4 të LPP-së baza për prapësimin duhet të mbështetet në prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim përndryshe prapësimi do të refuzohet, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si të pa bazuar dhe urdhrin përmbarimor ta vërtetoj.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit në prapësim dhe për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin konform nenit 73 par. 1 të LPP-së ka caktuar seancë dëgjimore me datën 11.05.2022, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesi me autorizim i kreditorit dhe përfaqësuesi i debitorit.

Përfaqësuesi i kreditorit në seancën dëgjimore ka deklaruar se gjatë zhvillimit të procedurës përmbimore janë përmbushur obligimet financiare nga ana e debitorit lidhur me objektin përmbarimor në vlerën e borxhit prej 8.547.75 Euro, ndërsa ka mbetur pa u përmbushur kamat prej 8% sipas propozimit për përmbarim, dhe shpenzimet e procedurës së krijuar deri më tani. Përfaqësuesi i debitorit në seancën dëgjimore ka deklaruar se pajtohet me propozimin e kreditorit, meqenëse, pasi që borxhi në këtë rastë është përmbushur nga debitori i ka propozuar gjykatës që të anuloj urdhrin përmbarimor P.nr. 266/21.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar me arsyetimin se përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit në seancën dëgjimore të datës 11.05.2022 ka pohuar se debitori e ka përmbushur borxhin kryesor në shumë të përgjithshme prej 8.547.75 Euro.

Gjykata ka vlerësuar me kujdes pretendimet e debitorit lidhur me përmbushjen e borxhit dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kemi të bëjmë me përmbushjen e borxhit kryesor të pohuar nga kreditorit.

Meqenëse në rastin konkretë është vërtetuar se debitori nuk i ka përmbushur obligimet e shpenzimeve procedurale si në pikën II të këtij dispozitivit të këtij Aktvendimi, Gjykata pjesërisht e pranoj prapësimin e debitorit për shumën prej 8.547.75 Euro, ndërsa pjesën tjetër e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata vlerësoj pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe në pajtim me nenin 73 par. 2 dhe 3 të LPP-së, e ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit lidhur me përmbushjen e borxhit kryesor, ndërsa e ka refuzuar prapësimin pjesërisht për pjesën që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të dispozitave ligjore të cekura më lartë

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL  
2021:132886, 17.05.2022

Gj y q t a r i  
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.